

Kapacitete të dobëta të shërbimeve inspektuese në vetëqeverisjet lokale



KAPACITETE TË DOBËTA TË SHËRBIMEVE INSEKTUESE NË VETËQEVERISJET LOKALE

Botim elektronik:

(Kapacitete të dobëta të shërbimeve inspektuese në vetëqeverisjet)

Titulli origjinal i botimit:

Слаби капацитети на инспекциските служби во општините

Botuesi:

Qendra për Komunikime Qytetare

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe:

Agon Ismaili

Dizajn grafik:

Relativ

Shkup, tetor 2024

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитetska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

35.072.6:352(497.7)"2023"(047.31)

СЛАБИ капацитети на инспекциските служби во општините [Електронски извор] = Weak capacities of the inspection services in the municipalities = Kapacitete të dobëta të shërbimeve inspektuese në vetëqeverisjet lokale / преведено од македонски на англиски јазик од Магдалена Симионска ; преведено од македонски на албански јазик од Агон Исмаили. - Текст во ПДФ формат, содрж. 16, 16, 16 стр. илустр. - Скопје :

Центар за граѓански комуникации ; Скопје : Center for Civil Communications ; Shkup : Qendra për Komunikime Qytetare, 2024

Начин на пристапување (URL):

<https://ccc.org.mk/images/kapaciteti-na-inspekcii.pdf>. - Наслов преземен од екран. - Опис на изворот на ден 16.10.2024 год. - Напореден текст на мак., англ. и алб. јазик

ISBN 978-608-4974-41-3

a) Инспекциски служби -- Локална самоуправа -- Македонија -- 2023 -- Извештаи од истражувања

COBISS.MK-ID 64552453



Kingdom of the Netherlands

Hulumtimi është përgatitur në kuadër të projektit "Mbrotjtje nga korrupsioni" me asistencë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, i zbatuar nga Qendra për Komunikime Qytetare, në periudhën nga 1 nëntor 2021 deri më 31 tetor të vitit 2024.



PËRMBAJTJA

- 4** GJETJET KRYESORE
- 5** SYNIMI I HULUMTIMIT
- 7** NUMRI I INSPEKTORËVE TË PUNËSUAR NË VETËQEVERISJET LOKALE
- 8** METODOLOGJIA PËR VLERËSIM TË RREZIQEVE
- 10** RAPORTET GJASHTËMUJORE PËR PUNËN E SHËRBIMIT INSPEKTUES
- 11** TË DHËNAT NGA PUNA E SHËRBIMEVE INSPEKTUESE PËR VITIN 2023
- 12** PROGRAMI PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT DHE PROCEDURAT E SHKRUARA
- 13** MBIKËQYRJA INSPEKTUESE NGA INSPEKTORATI ADMINISTRATIV I SHTETIT
- 14** REKOMANDIME

GJETJET KRYESORE

- Në secilën nga vetëqeverisjet lokale të analizuara vërehet një plotësim i jotërësishëm të vendeve të punës në sektorët për mbikëqyrje inspektuese, diçka që në disa prej vetëqeverisjeve lokale shkon edhe deri në atë shkallë që të ketë mungesë edhe të gjysmës së personelit të paraparë në njësinë organizative përkatëse – shërbimi inspektues, ndërkaq në disa prej tyre edhe pozitat udhëheqëse janë bosh.
- Asnjë nga vetëqeverisjet lokale nuk ka përpiluar Metodologji për vlerësim të rreziqeve.
- Vetëm dy prej vetëqeverisjeve lokale e respektojnë detyrimin ligjor për përpilim të raporteve gjashtëmujore për punën e kryer nga shërbimi inspektues në suazat e komunës si dhe për publikimin e tyre në ueb-faqe.
- Dallime të mëdha ndërmjet komunave janë vërejtur për sa i përket numrit të paralajmërimeve të shqiptuara dhe aktvendimeve të lëshuara nga shërbimet inspektuese, me atë që në disa komuna në nivel vjetor janë shqiptuar më shumë se 1000, kurse në të tjera nuk është shqiptuar asnjë paralajmërim apo aktvendim. Kjo situatë shkakton dyshime për mosefikasitetin e shërbimeve dhe për korrupsion.
- Në veçanti shqetëson fakti që asnjë nga vetëqeverisjeve lokale, për shërbimin inspektues nuk ka miratuar ndonjë program për parandalim të korrupsionit dhe as një procedurë të brendshme për parandalim të konfliktit të interesave.
- Numri i mbikëqyrjeve inspektuese që i ka zbatuar nëpër komuna Inspektorati Administrativ i Shtetit dallon prej komune në komunë, ndërkaq ka komuna në të cilat mbikëqyrje inspektuese nuk është zbatuar në një periudhë më të gjatë kohore.
- Komunat në të cilat është zbatuar mbikëqyrje inspektuese nga Inspektorati Administrativ i Shtetit nuk i publikojnë konstatimet e Inspektoratit në ueb-faqet e tyre.

SYNIMI I HULUMTIMIT

Synimi i hulumtimimit është të identifikohen gjendjet me mbikëqyrjen inspektuese në njësitë e vetëqeverisjeve lokale. Hulumtimi është stimuluar nga rreziqet për korrupsion që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese, ndërkaq të cilat e imponojnë domosdoshmërinë për analizë mbi praktikat ekzistuese, detektim të problemeve dhe hartim të rekomandimeve përkatëse për rritjen e transparencës dhe integritetit të këtyre procedurave.

Strategjia Nacionale për Parandalim të Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave për periudhën 2021 – 2025, mbikëqyrjen inspektuese e identifikon si një nga pesë fushat horizontale në të cilat krijohen rreziqe të forta për korrupsion. Në përputhje me strategjinë, për një zbatim konsekuent të normave, i domosdoshëm është përforsimi i mekanizmave për kontroll dhe inspektim, përmirësimi i kuadrit ligjor dhe fuqizimi i resurseve njerëzore dhe materiale të autoriteteve mbikëqyrëse, por edhe avancimi i vazhdueshëm i diturive, aftësive dhe integritetit të punonjësve si dhe avancim i rezistencës së tyre ndaj korrupsionit. Mbikëqyrja inspektuese e cila nuk është mjaftueshëm funksionale në vetëqeverisjen lokale është cekur si një nga problemet prioritare për sa u përket autoriteteve që e zbatojnë ligjin. Sipas strategjisë, me procesin e decentralizimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në njësitë e vetëqeverisjes lokale është inkorporuar kategoria “inspektorë të autorizuar komunalë”, të cilët kanë statusin e nëpunësve administrativë. Në të njëjtën kohë, nuk ka harmonizim të kompetencave të inspektorëve

shtetërorë dhe inspektorëve komunalë. Një numër i madh i vetëqeverisjeve lokale kanë një shërbim të vogël administrativ, prandaj punët e mbikëqyrjes inspektuese i kryejnë persona me autorizime që u jepen nga kryetarët e komunave, ndërkaq ata nuk i kanë kualifikimet dhe njohuritë e duhura. Ligji për Ndërtim, ligjet nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nuk sigurojnë pavarësi dhe autonomi të inspektorëve të autorizuar në veprimin e tyre dhe miratimin e akteve nga ana e tyre, si dhe ka ndikime të forta edhe nga kryetarët e komunave edhe nga palët e tjera të interesuara në veprimin e atyre inspektorëve. Për të përmirësuar sistemin e mbikëqyrjes inspektuese në nivel lokal, është e nevojshme të forcohet integriteti i shërbimeve inspektuese dhe plotësimi i tyre me personel profesional.

Ky hulumtim është zbatuar në tetë komuna të synuara (Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Negotinë, Tetovë, Strumicë, Çair dhe Shtip), por duhet theksuar se Komuna e Negotinës, përkundër të gjitha përpjekjeve për të siguruar të dhënat përkatëse, nuk ka dërguar përgjigje dhe nuk është përfshirë në hulumtimin për arsyen e thjeshtë se nga komuna nuk u përgjigjën në kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik dhe të dhënat që janë temë e këtij hulumtimi mbetën të pazbuluara.

Me qëllim të sigurimit të të dhënave në lidhje me mbikëqyrjen inspektuese nëpër komunitat, Qendra për Komunikime Qytetare, së bashku me organizatat joqeveritare të përfshira në realizimin e projektit “Mbrojtje nga korrupsioni” (Qendra

Kulturore Rinore – Manastir, Koalicioni Rural. Qendra për Dialog Ndërkulturor, Shoqata ekologjike “Villa Zora” Veles, Shoqata qytetare – Qendra për Hulumtime dhe Analiza NOVUS Strumicë, Shoqata Multikulturore, Shoqata qytetare ZIP Instituti për Politika dhe Qeverisje të Mirë dhe EHO (Organizatë edukative-humanitare), kanë parashtruar kërkesa identike për qasje tek informacionet me karakter publik deri te secila prej tetë komunave të përfshira me këtë projekt. Janë kërkuar të dhëna për numrin e inspektorëve të licencuar të punësuar në komunat, sipas fushave, kategorive dhe niveleve të vendeve të punës së inspektorëve, edhe atë për gjendjet në vitin 2019 dhe vitin 2023, si dhe për numrin e vendeve të punës që janë paraparë për inspektorët në përputhje me sistematizimin e vendeve të punës në vetëqeverisjen lokale. Gjithashtu, janë kërkuar metodologjitë për vlerësimin e rreziqeve, të cilat i miratojnë udhëheqësit e shërbimeve inspektuese, raportet gjashtëmujore për punën e kryer nga shërbimi inspektues në vitin 2023 dhe linqet për publikimet e tyre në faqet e internetit të komunave; të dhënat për numrin e paralajmërimeve dhe të aktvendimeve për mënjanimin e parregullsive dhe mangësive që janë shqiptuar nga shërbimi inspektues në vitin 2023; të dhëna për numrin e kërkesave për ngritje të procedurës për kundërvajtje apo të procedurës penale në vitin 2023; programi për parandalim të korrupsionit i shërbimit inspektues; procedurat e hartuara për parandalimin e konfliktit të interesave për inspektorët; të dhëna për numrin e mbikëqyrjeve inspektuese të zbatuara në komunë nga Inspektorati Administrativ i Shtetit në periudhën 2021 – 2023; të dhëna lidhur me atë se çfarë parregullsi ka konstatuar inspektorati gjatë mbikëqyrjeve inspektuese të zbatuara.

NUMRI I INSPEKTORËVE TË PUNËSUAR NË VETËQEVERISJET LOKALE

- Në secilën nga vetëqeverisjet lokale të analizuar vërehet plotësim i jotërësishëm i vendeve të punës në njësitë organizative për mbikëqyrjen inspektuese dhe ndonjëherë mungojnë edhe udhëheqësit e këtyre njësiteve organizative (përkatësisht të shërbimeve inspektuese).

Mbikëqyrja inspektuese zbatohet me qëllim të mbikëqyrjes së implementimit të ligjeve dhe normave të tjera dhe akteve të përgjithshme në funksionimin e subjekteve që i nënshtrohen mbikëqyrjes inspektuese. Shërbimet inspektuese në njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të organizuara si njësi organizative për mbikëqyrje inspektuese.

Në secilën nga vetëqeverisjet lokale e analizuar vërehet një plotësim i pjesshëm në vendet e punës të parapara për inspektorët komunalë. Sipas sistematizimeve të shtatë vetëqeverisjeve lokale të analizuar, gjithsej janë paraparë 118 vende pune, ndërsa të plotësuara janë 74, ose vetëm 63 %.

Pjesa më e madhe e vendeve të punës që nuk janë të plotësuara është në Komunën e Çairit, në të cilën madje 50 % e vendeve të parapara të punës janë të paplotësuara, kurse shkalla më e lartë e plotësimit të vendeve të punës është në Komunën e Tetovës, me 72 %.

Numri i të punësuarve dhe inspektorëve që janë paraparë në vetëqeverisjet lokale

Vetëqeverisja lokale	Numri i të punësuarve	Numri i paraparë	Shkalla e plotësimit të vendeve të punës
Tetovë	23	32	72%
Shtip	9	14	64%
Kumanovë	12	19	63%
Manastir	11	18	61%
Kërçovë	5	9	56%
Strumicë	11	20	55%
Çair	3	6	50%
Negotinë	Nga vetëqeverisja lokale nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara.		

Sipas fushave, më së shumti ka inspektorë komunalë (21), inspektorë nga fusha e ndërtimit dhe urbanizmit (14) dhe inspektorë për mjedis jetësor. Ndërkaq, nga ana tjetër, numri më i madh i vendeve të të paplotësuara për inspektorë është në fushën e rrugëve dhe komunikacionit rrugor (9), në fushën e ndërtimit dhe urbanizmit (7) dhe sferën e banimit (5).

Në disa nga komunat, gjithashtu është i dukshëm edhe mosplotësimi i disa prej pozitave udhëheqëse. Pra, në Komunën e Manastirit nuk janë të plotësuara pozitat Udhëheqës i Seksionit për Inspeksion Komunal dhe për Inspeksion për Mjedis Jetësor dhe Udhëheqës i Seksionit për Inspeksion për të Ardhura, Turizëm, Hotelieri, Arsim dhe Sport; në Komunën e Strumicës, pozita e Udhëheqësit të Seksionit për Punë Inspektuese në Financa, Arsim, Sport, Hotelieri, Turizëm dhe inspeksione tjera në kompetencë të komunës dhe në Komunën e Shtipit, pozita e paraparë për Udhëheqës të Seksionit për Mbikëqyrje Urbanistike, Ndërtimore dhe Mbikëqyrje të Komunikacionit Rrugor dhe të Rrugëve.

METODOLOGJIA PËR VLERËSIM TË RREZIQEVE

- **Asnjë nga vetëqeverisjet lokale nuk ka përpiluar Metodologji për vlerësim të rreziqeve.**

Sipas nenit 32 paragrafi (4) i Ligjit për Mbikëqyrje Inspektuese, vlerësimi i rreziqeve përfshin analizë, menaxhim dhe raportim për rrezikun dhe kjo bëhet sipas metodologjisë për vlerësim të rreziqeve, të cilën e miraton udhëheqësi i shërbimit inspektues pasi paraprakisht të jepet mendimi nga Këshilli për Përputhshmëri.


Nga komunat është kërkuar ta dërgojnë metodologjinë, mirëpo rezultoi se asnjëra prej tyre nuk e ka dokumentin konkret.

Në përgjigjen për kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, Komuna e Strumicës distancohet nga detyrimi ligjor duke u thirrur në nenin 32 paragrafi (4), në të cilin është përcaktuar që metodologjia për vlerësim të rreziqeve është miratuar nga udhëheqësi i shërbimit inspektues nga neni 26, paragrafi (1), pika 1 (organet në kuadër të ministrive – inspektorate shtetërore për fusha të posaçme) dhe pika 2.2 (njësitë organizative për mbikëqyrjen inspektuese në organet e administratës shtetërore). Me fjalë të tjera, interpretimi i Komunës së Strumicës është se vetëqeverisjet lokale nuk e kanë për detyrë të miratojnë metodologji për vlerësim të rreziqeve, për shkakun se neni 32, paragrafi (4) nuk sugjeron që metodologji miratojnë edhe udhëheqësit e shërbimeve

inspektuese nga neni 26, paragrafi (1), pika 3 (njësitë organizative për mbikëqyrje inspektuese në suazat e komunave, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit). Është fakt se në nenin 32, paragrafin (4) nuk janë përmendur në mënyrë konkrete komunat kur është rregulluar detyrimi për të miratim të metodologjisë për vlerësim të rreziqeve. Por, gjithashtu duhet pasur parasysh se interpretimet e ngushta të ligjeve çojnë në situata faktike të palogjikshme. Si e para, si do të bënin vetëqeverisjet lokale vlerësim të rrezikut nëse nuk kanë një metodologji për të bërë këtë? Si e dyta, edhe nëse nuk kanë detyrim konkret për miratim të metodologjisë për vlerësim të rreziqeve, komunat nuk do të kenë asnjë dëm nëse, në fakt, miratojnë metodologji. Si e treta, Ligji për Mbikëqyrje Inspektuese thuhet në asnjë bazë tjetër nuk bën dallimin ndërmjet inspektorateve komunale dhe shërbimeve tjera inspektuese, prandaj është e palogjikshme që të ketë trajtim ndryshe pikërisht kur bëhet fjalë për miratimin e një metodologjie për vlerësim të rreziqeve. Në fakt, në nenin 2 të Ligjit për Mbikëqyrje Inspektuese, në mënyrë konkrete është përcaktuar se dispozitat nga i njëjti vlejnë edhe për inspektoratet komunale. Prandaj, interpretimi i ngushtë se (për shkak të faktit se neni 32, paragrafi (4) nuk udhëzon në nenin 26, paragrafi (1) dhe paragrafi (3)) komunat nuk kanë detyrim për të miratuar metodologji për vlerësim të rreziqeve është i palogjikshëm – meqë ato, sikur edhe çdo inspektorat tjetër, duhet të bëjnë vlerësimin e rreziqeve, duhet të kenë edhe metodologji për këtë.

Nga Komuna e Kumanovës janë përgjigjur që Seksioni për Mbikëqyrje Inspektuese pranë komunës ka miratuar Vendim për përcaktimin e koeficientit të kompleksitetit të mbikëqyrjes inspektuese, i cili përcaktohet në bazë të kriterëve ligjore: kushtet në të cilat zbatohet mbikëqyrja inspektuese dhe ekspozimi i inspektorit ndaj ndikimeve të mundshme mbi shëndetin dhe jetën e tij, numrin e subjekteve që i nënshtrohen mbikëqyrjes inspektuese, numrin e normave në bazë të të cilave zbatohet mbikëqyrja inspektuese dhe koha e nevojshme për zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, si dhe janë përgjigjur që në rrjedhë është procedura e krijimit të një regjistri të rreziqeve.

Në përgjigjen e Komunës së Manastirit përmendet vetëm detyrimi ligjor për miratimin e metodologjisë pa e dërguar dokumentin konkret. Komuna e Çairit referon në një rregullore të përpiluar nga Inspektorati i Shtetit për Vetëqeverisje Lokale për metodologjinë për vlerësim të rreziqeve, ndërsa Komuna e Tetovës është në procedurë të miratimit të metodologjisë. Komuna e Kërçovës dhe Komuna e Shtipit pohojnë se nuk kanë një metodologji të tillë.



RAPORTET GJASHTËMUJORE PËR PUNËN E SHËRBIMIT INSPEKTUES

- Vetëm dy nga vetëqeverisjet lokale e respektojnë detyrimin ligjor për përpilimin e raporteve gjashtëmujore për punën e shërbimit inspektues në kuadër të vetëqeverisjes lokale dhe për t'i publikuar ato në ueb faqen e vetëqeverisjes lokale.

Nga vetëqeverisjet lokale kemi kërkuar edhe informacione për numrin e paralajmërimeve dhe aktvendimeve që janë shqiptuar nga shërbimi inspektues për mënjanim të parregullsive dhe mangësive, kemi kërkuar numrin e kërkesave për ngritje të procedurës penale dhe procedurës për kundërvajtje, si dhe numrin e kërkesave të hedhura poshtë në vitin 2023.

Sipas nenit 35 të Ligjit për Mbikëqyrjen Inspektuese, udhëheqësi i shërbimit inspektues e ka për detyrë të miratojë raport gjashtëmujor, edhe atë më së voni deri më 15 korrik për periudhën janar - qershor të vitit aktual, përkatësisht më së voni deri më 15 janar për periudhën korrik - dhjetor të vitit paraprak, ndërsa këto raporte publikohen në faqen e internetit të shërbimit inspektues.

Vetëm komunat Manastir dhe Kumanovë kanë dorëzuar raporte konkrete gjashtëmujore për punën e shërbimit inspektues, të cilat gjithashtu janë të publikuara në faqet e internetit të vetëqeverisjeve lokale. Nga Komuna e Tetovës, në përgjigjen e tyre kanë paraqitur të dhëna që kanë të bëjnë me punën e shërbimit inspektues, por nuk kanë dërguar raporte gjashtëmujore dhe përveç kësaj, ato nuk mund t'i gjejmë as në ueb faqen e vetëqeverisjes lokale. Komunitet Kërçovë, Strumicë, Çair dhe Shtip nuk e respektojnë detyrimin ligjor për përpilimin e raporteve të këtilla.

TË DHËNAT NGA PUNA E SHËRBIMEVE INSPEKTUESE PËR VITIN 2023

Sipas Ligjit për Mbikëqyrje Inspektuese, qëllimi i mbikëqyrjes inspektuese është veprimi parandalues ose ndërmarrje e masave për parandalimin ose eliminimin e pasojave mbi mallrat e mbrojtura, të drejtat ose interesat, si dhe shqiptimi i masave inspektuese për mënjanimin e parregullsive dhe mangësive të konstatuara.

Mbikëqyrja inspektuese zbatohet në përputhje me planin mujor për punë të secilit inspektor ose me urdhër me shkrim nga drejtori ose personi udhëheqës i autoritetit, përkatësisht kryetari i komunës, në suazat e së cilës është shërbimi inspektues, si dhe me urdhër të lëshuar nga Këshilli. Mbikëqyrja inspektuese mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme dhe kontrolluese.

Gjatë zbatimit të inspektimit, inspektori me aktvendim e shqipton masën paralajmërim dhe përcakton afat, në të cilin subjekti i inspektuar e ka për detyrë t' i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë e përcaktuara në procesverbal. Si përjashtim, në rast se inspektori vlerëson se parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara kanë potencial për të shkaktuar ose ato shkaktojnë rrezik të menjëhershëm për jetën dhe shëndetin e njerëzve, apo dëm financiar ose dëm të pronës me vlerë më të madhe, ose rrezikim të mjedisit jetësor, ose rrezikim të interesit publik, me aktvendim shqipton tjetër masë inspektuese, sikur detyrim, urdhër, ndalim dhe masë tjetër, nëse ajo masë tjetër është përcaktuar me ligj të posaçëm, me të cilën më së miri do të përmbushet objektivi i mbikëqyrjes inspektuese.

Të dhënat nga puna e mbikëqyrjes inspektuese

Vetëqeverisja lokale	Numri i paralajmërimeve të shqiptuara dhe aktvendimeve të lëshuara	Numri i kërkesave për ngritje të procedurës penale ose procedurës për kundërvajtje	Numri i kërkesave të refuzuara të ngritje të procedurës penale ose procedurës për kundërvajtje
Kumanovë	1282	51	Nuk ka të dhëna
Manastir	591	3	0
Shtip	456	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
Tetovë	268	0	0
Strumicë	191	63	0
Kërçovë	29	0	0
Çair	0	0	0
Negotinë	Nga vetëqeverisja lokale nuk i kanë dërguar të informacionet e kërkuara.		

Në bazë të dhënave që na janë dërguar, shërbimi inspektues i Komunës së Kumanovës ka shqiptuar më së shumti masa për paralajmërim dhe aktvendime, edhe atë 1.282, para Komunës së Manastirit me 591 dhe Komunës së Shtipit me 456, ndërkaq asnjë paralajmërim apo aktvendim nuk është lëshuar në komunën e Çairit. Ky fakt shkakton dyshime të forta për korrupsion për arsye se nuk është e pakuptueshme se si shërbimi inspektues nuk ka shqiptuar asnjë paralajmërim dhe nuk ka lëshuar asnjë aktvendim për detyrim gjatë një viti të tërë kalendarik. Në anën tjetër, shërbimi inspektues i Komunës së Strumicës ka parashtruar më së shumti kërkesa për ngritje të procedurës penale apo për procedurë për kundërvajtje.

PROGRAMI PËR PARANDALIM TË KORRUPSIONIT DHE PROCEDURAT E SHKRUARA

- Asnjëra nga vetëqeverisjet lokale nuk ka të miratuar ndonjë program për parandalim të korrupsionit për shërbimin inspektues dhe as një procedurë të brendshme për parandalim të konfliktit të interesave.

Nga vetëqeverisjet lokale që janë përfshirë me këtë hulumtim janë kërkuar programet e shërbimeve inspektuese lidhur me parandalimin e korrupsionit, si dhe procedurat e brendshme për parandalim të konfliktit të interesave. Shqetëson fakti se asnjëra nga këto vetëqeverisje lokale nuk ka të miratuar program për parandalim të korrupsionit për shërbimin inspektues dhe as procedurë të brendshme për parandalim të konfliktit të interesave.

Komuna e Manastirit miraton vetëm plan për parandalimin e korrupsionit dhe parandalimin e konfliktit të interesave dhe thirret në respektimin e kuadrit ligjor që e mbulon fushën e parandalimit të konfliktit të interesave. Komuna e Çairit i referohet Kodit Etik për Inspektorët i miratuar nga Inspektorati Shtetëror Komunal si program kryesor për luftë kundër korrupsionit, ndërsa Komuna e Strumicës në përgjigjen e saj thotë se procedura për konflikt të interesave është e rregulluar në nenin 25 të LPPA-së.



MBIKËQYRJA INSPEKTUESE NGA INSPEKTORATI ADMINISTRATIV I SHTETIT

Sipas Ligjit për Inspektim Administrativ, Inspektorati Administrativ i Shtetit në suazat e kompetencave të tij e mbikëqyr edhe zbatimin e Ligjit për Mbikëqyrje inspektuese.

Sipas të dhënave të fituara nga vetëqeverisjet lokale mund të vërehet se numri i mbikëqyrjeve inspektuese që janë zbatuar nëpër komunat gjatë periudhës nga viti 2021 deri në vitin 2023 lëviz nga zero deri në 55. Së këtejmi, mund të konstatohet se Inspektorati Administrativ i Shtetit nuk zbaton mbikëqyrje në të gjitha komunat ose, nga tjetra anë, numri i inspektimeve të zbatuara është joproportionalisht më i lartë në disa komuna krahasuar me numrin e mbikëqyrjeve të zbatuara në disa komuna tjera.

Për sa u përket parregullsive të konstatuara, përgjigje konkrete japin vetëm dy komuna; Komuna e Kërçovës - se nuk janë konstatuar parregullsi dhe Komuna e Kumanovës – është konstatuar se janë shkelur afatet që janë përcaktuar gjatë përpilimit të akteve të inspektimit. Shkelja e afateve paraqet shkelje të rregullave procedurale, që mund të rezultojë me anulim të aktit të inspektimit nëse subjekti i mbikëqyrur parashton ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Fushën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse.

Numri i mbikëqyrjeve inspektuese nga Inspektorati Administrativ i Shtetit në periudhën 2021 – 2023

Vetëqeverisja lokale	Numri i mbikëqyrjeve inspektuese
Çair	55
Shtip	42
Tetovë	12
Kumanovë	11
Kërçovë	10
Manastir	0
Strumicë	Nuk ka të dhëna
Negotinë	Nga vetëqeverisja lokale nuk i kanë dërguar të informacionet e kërkuara

REKOMANDIME

- Vetëqeverisjet lokale duhet t'i plotësojnë vendet vakante në sektorët për mbikëqyrje inspektuese me personel përkatës profesional, me ndihmën e të cilit do të rritet intensiteti dhe cilësia e mbikëqyrjeve inspektuese, ndërsa me këtë, edhe i zbatimit të ligjeve, si dhe të bëjnë furnizimin e shërbimeve për mbikëqyrje inspektuese me pajisje teknike.
- Miratimi i metodologjive për vlerësim të rreziqeve nga të gjitha vetëqeverisjet lokale.
- Përpilimi i raporteve gjashtëmujore për punën e shërbimeve inspektuese të vetëqeverisjeve lokale në të cilat, në mënyrë të detajuar do të paraqiten mbikëqyrjet inspektuese të zbatuara dhe gjetjet gjatë atyre mbikëqyrjeve.
- Publikim transparent i masave të shqiptuara për paralajmërim dhe aktvendimet e lëshuara nga shërbimet inspektuese, si dhe publikimi i vendimeve përfundimtare nga procedurat për kundërvajtje dhe nga procedurat penale, nëpërmjet të cilave do të ngritet vetëdija e qytetarëve dhe do të zvogëlohet numri i kundërvajtjeve ndërsa njëkohësisht do të rritet besimi i qytetarëve në punën e shërbimeve inspektuese.
- Miratim i programeve përkatëse për luftë kundër korrupsionit dhe miratim i procedurave të brendshme të shkruara për parandalim të konfliktit të interesave.
- Inspektorati Administrativ i Shtetit duhet të zbatojë mbikëqyrje inspektuese në të gjitha komunat, në përputhje me kompetencat që i ka dhe gjetjet nga ato mbikëqyrje duhet të bëhen publike për publikun, si nga inspektorati ashtu edhe nga ana e vetëqeverisjet lokale.
- Zhvillim i anketave dhe sondazheve të kohëpaskohshme në lidhje korrupsionin tek inspektorët me subjektet që i nënshtrohen mbikëqyrjes inspektuese, rotacion i kohëpaskohshëm për inspektorët në rajonet në të cilat ata e zbatojnë mbikëqyrjen inspektuese dhe futja e një pjese të detyrueshme në provimin për inspektor në të cilën do të përfshihet aspekti i integritetit dhe etikës.

